



Nr. 1480/Prot

Dt. 11.04.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 244/1 prot

Shkodër, më 8.04.2025

LËNDA: Mbi vendimin Nr.18, datë 26.03.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 49/pika 2, 3, 4/e dhe pika 5, neni 54 gërma j, neni 55/3, u njoh me vendimin **Nr.18, datë 26.03.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës** sipas dokumentacionit shoqërues (bashkëlidhur) dërguar nga sekretari i Këshillit Bashkiak "Humbje mandati Kristjana Kovaçi, si pasojë e mosmarrjes pjesë në mbledhjet e KB për një periudhë 6-mujore".

Prefekti ju lejon procedimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

VENDIM

Nr 18 .datë 26.03 .2025

PËR:

“Për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës”

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 49, pika 2,pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës:

VENDOSI:

1. Miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës **Znj.Kristjana Kovaçi**, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 49, pika 4 germa (e) për shkak se nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës për një periudhë 6 mujore.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj

Miratuar me 18 vota

Vota Pro 18

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me date 02.04.2025

Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

Nr. 1179 Prot.

Vau Dejës me 07/03/2025

PROJEKT VENDIM

PËR:

"Për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës"

Komisioni i mandateve të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49, pika 2, pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, i propozon Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

VENDOSI:

1. Miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës **Znj. Kristjana Kovaçi**, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49, pika 4 germa (e) për shkak se nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës për një periudhë 6 mujore.

Kryetari Këshillit
Ervis Shimaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa,Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail:info@vaudejes.gov.al)

RELACION

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 49, pika 4, germa e,dhe në rregulloren nr.23 datë 24.04.2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës"neni 21, pika 1, germa g, ju raportoj si më poshtë:

Këshilltarja e Këshillit Bashkiak Vau Dejës,Znj.Kristjana Kovaçi (përfaqësuese e subjektit politik P.S.D) nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për një periudhë 6-mujore rresht,dhe konkretisht:Nga mbledhja e muajit Shtator 2024 deri në mbledhjen e muajit Shkurt 2025. Sqaroj se Këshilli Bashkiak Vau Dejës ka zhvilluar mbledhje normale të rradhës për ç`do muaj si më poshtë:

Mbledhja e muajit Shtator është bërë me datë 27.09.2024.

Mbledhja e muajit Tetor është bërë me datë 30.10.2024.

Mbledhja e muajit Nëntor është bërë me datë 27.11.2024.

Mbledhja e muajit Dhjetor është bërë me datë 23.12.2024.

Mbledhja e muajit Janar është bërë me datë 29.01.2025.

Mbledhja e muajit Shkurt është bërë me datë 26.02.2025.

Në të gjitha këto mbledhje të Këshillit Bashkiak Vau Dejës,Këshilltarja Znj.Kristjana Kovaçi ka munguar pa shprehur ndonjë arsye.

Sa më sipër :

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

(Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës e-mail: info@vaudejes.gov.al)

PROPOZIM

“Për humbjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës”

Komisioni i mandateve të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 49, pika 2, pika 4 germa e, pika 5 dhe neni 54 germa j, i propozon Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të:

PROPOZOJMË

1. Miratimin e humbjes së mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, Znj. Kristjana Kovaçi.

Komisioni i Mandateve:

Z. Neki Kapllanaj – Kryetar

Z. Marin Dodaj – Sekretar

Znj. Kristjana Kovaçi – Anëtar (*humb mandatin*)